



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

Vendim
Nr. 78 Date : 25/10 2019

Për dhënie pëlqimi për kalimin e të drejtës së pronësisë për efekt legalizimi të parces ndërtimore në posedim të z. Gasper Dode Shkreli.

Nisur nga kërkesa e Agjencise Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Shkoder, me nr. Prot. 8572 date 21.10.2019 si dhe referuar ligjit 9482 datë 3.4.2006 “ Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve informale” ndryshuar, neni 15/1 pika 2, VKM nr 465 date 22.06.2016 “ Për Përcaktimin e Proçedurave dhe Rregullave për Kalimin e së Drejtes së Pronësisë mbi Parcelen Ndërtimore të Objekteve Informale” pika 19 ku citohet se:

Kërkesa për miratim nga bashkia kompetente, sipas pikës 2, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, paraqitet nga drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t, përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe masës e vlerës së kompensimit financiar. Kjo kërkesë paraqitet për të gjitha parcelat ndërtimore në pasuritë e transferuara në pronësi të bashkisë, brenda territorit të njësisë administrative përbërëse.

Kërkesa merret në shqyrtim nga këshilli bashkiak, i cili duhet të vendosë për miratimin e tjetërsimit, duke nxjerrë pasuritë (ose pjesë të tyre) nga inventari i pronave të bashkisë. Kur bashkia ka vetëm të drejta administrimi mbi pasurinë, ajo njoftohet për faktin e kalimit të pronësisë përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, me qëllim nxjerrjen e pasurisë (ose pjesës së saj) nga inventari i pronave të bashkisë.

Si dhe mbeshetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqerisjen vendore”, neni 54, 55, ndryshuar.

Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumice te cilesuar te votave,

VENDOSI

- Ti jepet pëlqim Agjencise Shtetërore te Kadstres, Drejtoria Shkoder per kalimin e se drejtes se pronesise te siperfaqes prej **98.4 m2** te parces ndertimore te z. Gasper Dode Shkreli, pjese e pasurise nr. **57/1**, ndodhur ne ZK **1329** , Nj.A. Bushat, Bashkia Vau Dejes, pasuri e cila eshte kaluar ne pronesi ish Komunes Bushat me VKM 68 dt. 28.01.2008(ndryshuar).